100 DITË BASHKË TË PËRKUSHTUAR PËR KUMANOVËN

KRYETARI DHE KËSHILLI I
KOMUNËS SË KUMANOVËS

100 DITË BASHKË TË PËRKUSHTUAR PËR KUMANOVËN

15.900м²+
ASFALTIM DHE RIPARIM

4.800м+
KANALIZIM FEKAL

5.700м²+
KUBËZA BETONI

20+
PROJEKTE DHE AKTIVITETET NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME

1.300м²+
TROTUARE

4
FUSHA SPORTIVE TE KOMPLETUARA DHE 1 NË NDËRTIM

130+
FIDANË TË MBJELLUR RISHTAZI

20+
PASTRIMI DEPONIVE TË EGRA

KRYETARI DHE KËSHILLI I KOMUNËS SË KUMANOVËS

KOMUNA E KUMANOVËS
2022

KRYETARI I KOMUNËS SË KUMANOVËS

Maksim Dimitrievski,
kryetar i Komunës së Kumanovës

Të nderuar bashkëqytetarë,

Jam i nderuar që në katër vitet e fundit në Komunën e Kumanovës keni njohur një partner real që punon ekskluzivisht në interesin tuaj qytetar. Jam veçanërisht mirënjohës për mbështetjen që më dhatë për herë të dytë në vitin 2021, për ta menaxhuar komunën tonë të përbashkët, dhe të kujdesem për të gjithë kumanovarët. Pas marrjes së pozitës së kryetarit të Komunës së Kumanovës, vazhduam pa u lodhur, me intensitet të shtuar, të realizojmë projekte që nënkuptojnë përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Kumanova është qytet i të gjithë qytetarëve pa dallime etnike, fetare, politike dhe çdo përkatësie tjetër. Çdo qytetar i Kumanovës meriton një jetë dinjitoze dhe ne si palë përgjegjëse, të cilëve na është besuar kjo detyrë dhe obligim, duhet t'ua sigurojmë atë.

Në 100 ditët e para të mandatit të dytë kemi zbatuar një sërë projektesh në fushën e infrastrukturës rrugore, për përmirësimin e kushteve në arsim, sport, kulturë, mbrojtje sociale, që zgjidh shumë probleme të bashkëqytetarëve tanë, dhe deri në vitin 2025 parashikojmë realizimin e 800 projekteve që do ta forcojnë komunën dhe do të krijojnë kushte më të mira për jetën e përditshme.

Besoj se së bashku do ta bëjmë Kumanovën vend më të mirë për të jetuar. Kumanova është e imja, e juaja, shtëpia jonë e përbashkët, familja, e tashmja dhe e ardhmja jonë. Ta ruajmë, kultivojmë, ndërtojmë së bashku në një qytet modern, të lumtur dhe të bukur për të gjithë ne.

KËSHILLI I KOMUNËS SË KUMANOVËS

Ivana Gjorgjievska,
kryetare e Këshillit të
Komunës së Kumanovës

Të nderuar kumanovarë,

Në 100 ditët e kaluara të mandatit të ri të Këshillit të Komunës së Kumanovës, kemi mbajtur 4 mbledhje ku bashkërisht diskutojmë dhe marrim vendime për një jetë më të mirë të qytetarëve që jetojnë në qytetin tonë. Këta tre muaj mundohemi që zëri dhe qëndrimi i secilit këshilltar të dëgjohet, dhe më pas, përmes një debati konstruktiv, së bashku vendosim për projektet që janë thelbësore për kumanovarët.

Kur bëhet fjalë për nevojat tuaja, ne duhet të jemi të bashkuar, të veprojmë së bashku, sepse, ju jeni prioriteti ynë, ne punojmë për t'ju shërbyer juve. Në periudhën e ardhshme, si kryetare e Këshillit, do të angazhohem për përfshirje më të madhe të të gjithë këshilltarëve, sepse nga ne prisni zgjidhje të shpejta dhe efektive për problemet lokale.

Komuna është e hapur për të gjithë qytetarët, për idenë, propozimin e gjithsecilit, por edhe kohen se si të përmirësohet Kumanova dhe si të përmirësohet jeta. Në këtë broshurë mund të informoheni për aktivitetet e realizuara në 100 ditët e para të mandatit, kurse ne vazhdojmë të punojmë me përkushtim, për t'ju informuar në mënyrë transparente dhe llogaridhënëse për të gjitha projektet e realizuara.

INFRASTRUKTURA

Ka përfunduar ndërtimi i rrugës "ASNOM" me trotuare.

Ka përfunduar asfaltimi i rrugës "207".

Ka përfunduar asfaltimi i rrugës "206".

Ka përfunduar asfaltimi i rrugës "205".

Ka përfunduar asfaltimi i rrugës "204".

Ka përfunduar asfaltimi i rrugës "203".

Ka përfunduar asfaltimi i rrugës "149".

Ka përfunduar asfaltimi i rrugës "146".

INFRASTRUKTURA

Ka përfunduar asfaltimi i rrugës "143".



Ka përfunduar asfaltimi i rrugës "145".

Janë asfaltuar rrugët në f. Kosturnik.



Janë asfaltuar rrugët në f. Agino Sellë.

Është asfaltuar rruga "620" kah f. Priovcë.

Me kubëza betoni është rregulluar krahu i rrugës "Mlladen Stojanoviq".

Me kubëza betoni është rregulluar rruga "Bozhidar Axhija".

Me kubëza betoni është rregulluar krahu 1,2,3 i rrugës "Revolucioni Popullor".

INFRASTRUKTURA

Me kubëza betoni është rregulluar rruga "Boro Sokolov" në lagjen Zelen Rid.

Me kubëza betoni është rregulluar krahu i rrugës "Vidoe Smilevski bato".

Me kubëza betoni është rregulluar krahu 1 i rrugës "Esperanto".

Me kubëza betoni është rregulluar krahu 2 i rrugës "Esperanto".

Me kubëza betoni është rregulluar rruga "33".

Me kubëza betoni është rregulluar rruga "3".

Me kubëza betoni është rregulluar rruga "52".

Është duke vazhduar ndërtimi i kolektorit kryesor fekale në aksin f. Çetircë – f. Tabanoc – f. Sopot.

KAPACITETE REKREATIVE – SPORTIVE

● Ka përfunduar rikonstruksioni i çatisë së sallës sportive. U çmontua çatia e vjetër e bakrit, u evidentua nga komisioni, u shënjua, u mat dhe u deponua në palestër, me një peshë totale prej 17.349 kg. Me Vendim të Këshillit komunal do të shitet me ankand publik, sipas çmimeve të bursës së bakrit, dhe të njëjtat mjete të grumbulluara do të riinvestohen në realizimin e fazave të tjera për rikonstruksionin e objektit.

● Vazhdon procedura për rikonstruksionin e tribunave, instalimin e dyshemesë së re profesionale në fushë sipas standardeve moderne të FIBA-s, pajisje dhe rekuizita sportive për palestër, pajisje sportive dhe pajisje për palestrën, semafor shumëdimenzional për monitorimin e rezultatit për ndeshje kampionati, kosha të rinj, gola dhe pajisje të tjera sportive.

● Ka përfunduar këndi i ri i lojërave shumësportive në oborrin e SHFK "Braqa Milladinovci" dhe SHFK "Kërste Misirkov".

● Ka përfunduar këndi i ri i lojërave shumësportive me sipërfaqe tartani në f. Kleçovcë.

● Vazhdon ndërtimi i këndit të ri të lojërave shumësportive me sipërfaqe tartani në f. Pçinjë.



● Kanë përfunduar këndet e reja multisportive me sipërfaqe tartani në Agino Sellë dhe në f. Rramanli.

ARSIMI

● Ka përfunduar rikonstruksioni i plotë i kulmit të SHMK Gjimnazi "Goce Dellçev".

● Është duke u bërë lyerja dhe vendosja e ndriçimit të ri LED në klasat e SHMK gjimnazi "Goce Dellçev".



● Po ndërrohet kulmi i sallës sportive të SHMK Gjimnazi "Goce Dellçev" dhe po bëhet renovimi i brendshëm i saj.

● Vazhdon vendosja e fasadës me efikasitet energjetik e tërë objektit të SHMK Gjimnazi "Goce Dellçev".

● Janë vendosur dyert e reja të klasave, ndërsa paraprakisht të gjitha dritaret e vjetra janë ndërruar me dritare të reja PVC në SHMK Gjimnazi "Goce Dellçev".

● Janë ndërruar dritaret e vjetra me dritare të reja PVC me efikasitet energjetik në objektin e SHFK "Magdalena Antova" - f. Karposh.

● Janë blerë 430 karrige poliuretani, pajisje të reja sportive për gjimnastikë, si dhe pajisje shtesë për kabinetin e muzikës në SHMK Gjimnazi "Goce Dellçev".

ARSIMI

● Janë duke u rikonstruktuar tualetet në SHFK "Kongresi i Manastirit" - f. Llopat.

● Janë ndërruar dyert dhe dritaret në objektin qendror të SHFK "Braqa Milladinovci" dhe SHFK "Krste Misirkov".

● Është duke u rregulluar dhe rrethuar oborri i shkollës në SHMK "Pero Nakov".

● Është duke u vendosur sistemi i ri i ngrohjes në sallën sportive të SHMK "Pero Nakov".

● Po ndërrohen dyert e vjetra, dritaret e vjetrat me dritare të reja PVC me efikasitet energjetik në SHMK "Pero Nakov", më pas do të vendoset fasada e re me efikasitet energjetik në të gjithë objektin.

● Janë blerë 7 tabela smart, 200 karrige dhe 100 banka, si dhe 97 kompjuterë për pajisjen dhe modernizimin e kabineteve të IT në objektin kryesor dhe të shpërndarë të SHMK "Pero Nakov".

ARSIMI

● Ka përfunduar fasada e re me efikasitet energjetik në SHMKT "Nace Bugjoni", janë blerë pajisje të reja kompjuterike, kondicionerë, karrige për zyre, 34 tavolina dhe 100 karrige shkollore.

● Po realizohet rikonstruksioni i objektit shkollor në SHFK "Karposh" – f. Umin Doll, ku parashikohet rikonstruksioni i çatisë, dyshemeve dhe tualeteve, dritareve dhe dyer të reja, fasada e re me efikasitet energjetik dhe sistem i ri ngrohjeje.

● SHFK "Kërste Misirkov" mori 7 kompjuterë personalë si donacion nga SEEBRIG dhe dy lloje fjalorësh nga 8 copë nga biblioteka personale SEEBRIG.

● Në SHFK "Vuk Karaxhiq" është vendosur rampa hyrëse dhe është përshtatur tualeti për personat me aftësi të kufizuara.

● Në shkollë janë duke u rikonstruktuar tualetet, është duke u vënë fasada e re me efikasitet energjetik dhe po vendoset një portë e re në oborrin e shkollës.

● Janë blerë 82 tabela interaktive (smart), mjete ndihmëse-teknike dhe pajisje për palestra, për nevojat e shkollave fillore në Komunën e Kumanovës.

MBROJTJA DHE INKLUZIONI SOCIAL

● Sipas programit për mbrojtje sociale të Komunës së Kumanovës për vitin 2022, do të vazhdojmë me masat për ndihmë për kategoritë e cenueshme të qytetarëve përmes këtyre aktiviteteve: Subvencionimi i shpenzimeve për shërbime komunale, të dedikuara për kategoritë e rrezikuara sociale të qytetarëve; Ofrimi i ndihmës për strehim materialisht dhe strehim të personave të pasiguruar - përfitues të asistencës minimale të garantuar (AMG) duke subvencionuar kostot e shërbimeve; Subvencionimi i shpenzimeve për transport publik urban dhe ndërurban të pensionistëve deri në 11.000 denarë; Ndihma e njëhershme financiare ose ndihma në natyrë, e cila konsiston në sigurimin e veshjeve, ushqimit dhe mjeteve të tjera të nevojshme për jetesën minimale të qytetarit dhe familjes, sipas vlerësimit të bërë nga Komisioni për dhënien e ndihmës së njëhershme financiare ose ndihmës në natyrë; Ofrimi i shërbimeve sociale përmes programit Punë e dobishme komunale me të cilën Komuna e Kumanovës me vite ofron shërbime sociale për kategoritë e cenueshme të qytetarëve, siç janë personat me aftësi të kufizuara - përfitues të qendrave ditore për persona me aftësi të kufizuara intelektuale në Komunën e Kumanovës, nxënësit me aftësi të kufizuara të përfshihen në arsimin e rregullt gjithëpërfshirës, të moshuarit dhe të tjerë; Kompetenca e deleguar nga Komuna e Kumanovës për ofruesit e autorizuar të shërbimeve sociale të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, si dhe shoqatat, personat e tjerë juridik dhe fizik; Realizimi i vazhdueshëm i projektit "Përfshirja e fëmijëve romë" në IPK Kopshti i Fëmijëve "Angell Shajçe" - Kumanovë; Vazhdimi i aktiviteteve të ekipit multidisiplinar për trajtimin e fëmijëve në rrugë/fëmijëve nër rrugë në Komunën e Kumanovës.

● Në Ditën Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, është vënë në shfrytëzim këndi gjithëpërfshirës i lojërave për nxënësit me aftësi të kufizuara, të përfshirë në paralele të rregullta në SHFK "Braqa Milladinovci" – Kumanovë. Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian dhe kompani - përgjegjëse shoqërore: "Alfi bi Company", "Prospera" dhe "Termalift" nga Kumanova, dhe zbatohet nga Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore "Hap pas Hapi", në kuadër të projektit " Bëhu in, bëhu përfshirës, bëhu i përfshirë", me partnerët Shoqata për promovim dhe zhvillim të shoqërisë inkluzive "Inkluziv" dhe Shoqata për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara "Handimak", me mbështetjen e Komunës së Kumanovës.

● Në SHFK "11 Tetori" - Kumanovë u hap dhoma senzoruese përmes projektit "Bëhu IN, bëhu INkluziv, bëhu i përfshirë" të realizuar nga Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore "Hap pas Hapi" - Shkup, në partneritet me Asociacionin për Promovimin dhe Zhvillimin e shoqërisë gjithëpërfshirëse "Inkluziva" nga Kumanova dhe Shoqatën për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar "Hendimak" - Tetovë. Dhoma e sensorëve, e shtata me radhë në vend, është donacion nga kompania me përgjegjësi sociale Alfi Bi-Kumanovë.

MBROJTJA DHE INKLUZIONI SOCIAL

● Tradicionalisht, në repartin e fëmijëve në ISHP Spitali i Përgjithshëm-Kumanovë, në prani të babadimrit iu ndanë pako për Vitin e Ri fëmijëve të akomoduar në repart. Kryetari Dimitrievski vizitoi edhe përdoruesit e Qendrës ditore për persona me aftësi të kufizuara intelektuale "Poraka Nasha" (Mesazhi ynë) dhe Qendrën ditore për persona me aftësi të kufizuara – Kumanovë, si dhe Shoqatën për persona të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim – Kumanovë, ku u shpërndanë pako.

● Në emër të Komunës së Kumanovës, me babadimrin u shpërndanë pako për Vitin e Ri për fëmijët pa prindër dhe përkujdesje prindërore të cilët janë të vendosur në familje kujdestare. Pako nga Komuna morën edhe fëmijët e komunitetit rom.

TAKIMET, SHËRBIMI PUBLIK DHE ADMINISTRATA

● Ambasadori David Gir, shef i Delegacionit të Bashkimit Evropian, me vizitën e tij në Komunën e Kumanovës, shënoi fillimin e vizitave komunale në vitin 2022. Ambasadori Gir shoqërohej nga Stephen Hudolin, shef i Delegacionit të BE-së për Bashkëpunim. Në takimin me kryetarin Dimitrievski u bisedua për mbrojtjen e mjedisit jetësor me marrjen e masave të duhura kundër ndotjes së ajrit, funksionimin e deponisë rajonale, bashkëpunimin e vazhdueshëm me të rinjtë, të cilët janë e ardhmja e çdo shoqërie. Pas takimit, ata vizituan qendrën multifunksionale - Hotel "Selaniku", ku na u bashkuan ambasadorët e rinj evropianë nga Kumanova, Albërie Xhemaili dhe Damjan Zllatanovski.

● Ambasadori i Federatës Ruse në RMV Sergej Aleksandroviç Baznikin vizitoi Komunën e Kumanovës, i shoqëruar nga Vladimir Hrisanfov, këshilltar për çështje ekonomike dhe tregtare në Ambasadë. Në takim u fokusua në vazhdimin e bashkëpunimit të frytshëm mes dy palëve, si dhe hapjen e mundësive të reja në disa fusha sociale.

● Përfaqësues të lartë nga Republika Srpska, Bosnjë dheHercegovinë dhe Republika e Serbisë bënë një vizitë zyrtare në Komunën e Kumanovës. Kryetari Dimitrievski u takua me kryetaren e R Srpska - Bosnjë dhe Hercegovinë, Zheljka Cvijanoviq, ambasadorin e Bosnje dhe Hercegovinës në RMV, Dragan Jakimoviq, Konsull nderi të R. së Serbisë në RMV, Vladimir Stajiq. Të pranishëm ishin edhe deputetë të RMV-së dhe anëtarë të Këshillit Komunal, të cilët janë pjesëtarë të komunitetit etnik serb.

TAKIMET, SHËRBIMI PUBLIK DHE ADMINISTRATA

● Kryetari Dimitrievski u takua me ambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë, SH.T Anke Holstein, ku u diskutua për një binjakëzim të mundshëm me një qytet nga Gjermania, si dhe u prezantuan mundësitë e investimit në zonën industriale "Novini dhe Reçica". Pas takimit, ata vizituan fabrikën Drexlmeier në Kumanovë, si investim gjerman në vend, fabrika e dytë e së cilës filloi punën në prill të vitit 2021.

● Dimitrievski, në zyrën e tij, u takua me Imzot Mitropolitin e Kumanovës dhe Osogovës Grigorij.

● Kryetari Dimitrievski realizoi takim me kryetarin e Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara "SOS Vita" – Shkup, Ertan Shakir me qëllim të shkëmbimit të përvojave, për përmirësim të jetës së përditshme të personave me aftësi të kufizuara.

● Kryetari Dimitrievski u takua me Ajni Kurtishin, këshilltar i Komunës Orbe (Kantoni Vaud Vd, Zvicër) dhe Hasan Kurtishin, kryetar i Shoqatës "Me ty Llopat" me seli në Zvicër. Në takim u diskutua për iniciativat e Shoqatës për donacione nga diaspora për realizimin e projekteve në fshatin Llopat.

● Me iniciativë të Dimitrievskit u mbajt takim i përbashkët i të gjithë kandidatëve për kryetarë të komunës së Kumanovës në zgjedhjet lokale 2021 me qëllim të diskutimit për përmirësimin e komunës sonë.

TAKIMET, SHËRBIMI PUBLIK DHE ADMINISTRATA

● Kryetari i Komunës së Kumanovës, Dimitrievski nënshkroi memorandum bashkëpunimi me përfaqësuesit e Asociacionit për Zhvillim Social dhe Demokraci OJQ "Pulsi i Demokracisë" - Kumanovë, si dhe me Asociacionin për Banim Human "Habitat Maqedoni" - Shkup.

● Së bashku me drejtorët e shkollave fillore komunale "11 Tetori" dhe "Hristijan Karposh", nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Fondacionin për Fëmijë "Pestaloci" - Trogen, Zvicër, për të vendosur dhe forcuar bashkëpunimin mes dy palëve për realizimin e projektit "Përfshirja e fëmijëve që janë jashtë shkollës në sistemin arsimor".

● Kryetari i Këshillit të Komunës së Kumanovës, me rastin e Ditës Botërore të Vullnetarizmit, 5 dhjetorit, pati takim me përfaqësues të shoqatës "Aksionarët e Kumanovës". Komuna vazhdon t'i mbështesë aktivisht shoqatat e këtij lloji, për t'i ushqyer traditat e angazhimit vullnetar me punë.

● Sekretari i Komunës u takua me profesorë përfaqësues nga Bullgaria, Turqia dhe Lituania, të cilët së bashku me SHMK Gjimnazi "Goce Dellçev" Kumanovë në mënyrë aktive punojnë në projektin "Mbrojtja e mjedisit" nga programi "Erasmus +" dhe veprojnë në temën "Aplikimi i burimeve të rinovueshme të energjisë".

● Komuna e Kumanovës vitin e kaluar ka prezantuar sistemin e informacionit gjeografik (GIS), i cili ka mundësuar disponueshmërinë e gjithë dokumentacionit urban online në territorin e Komunës. Nëpërmjet përmirësimit, tashmë kemi module për organizimin e një sondazhi publik dhe prezantimi publik, të cilat ofrojnë transparencë të plotë në procedurën e miratimit të dokumentacionit urban dhe mundësinë e marrjes së njoftimeve në bazë të pikave të interesit.

TAKIMET, SHËRBIMI PUBLIK DHE ADMINISTRATA

● Është mbajtur debat publik me organizatat dhe fondacionet e shoqërisë civile, në të cilin janë shqyrtuar dhe përcaktuar fushat prioritare të Komunës për projektin "Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD 2)", sipas të cilit Komuna ka filluar zbatimin e aktiviteteve.

● Komanda e SEEBRIG ka mbajtur trajnim për punonjësit e SEEBRIG dhe përfaqësuesit nga Komuna e Kumanovës. Trajnues ishte një instruktor nga kompania private e konsulencës "Hatec SA" - Greqi, me temën "Menaxhimi i Riskut".

● Kryetari Dimitrievski mori pjesë në promovimin e fushatës së re "BE me TY", në fokus të Marrëveshjes Evropiane të Gjelbër.



● Në prezantimin e aktiviteteve projektuese nga projekti "Së bashku për komunitet të prosperuar" morën pjesë sekretari i Komunës së Kumanovës, Aleksandar Gelevski dhe kryetarja e Këshillit të Komunës, Ivana Gjorgjievska.

● Zyrtari për të rinjtë në Komunën e Kumanovës dhe kryetari Dimitrievski morën pjesë në diskutimin për njohjen e të rinjve në Kumanovë me shërbimet rinore të parashikuara në Ligjin për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore, organizuar nga Qendra për Dialog Ndërkulturor (CID).

● Tradicionalisht, Komuna e Kumanovës shpalli policin më të mirë dhe zjarrfikësin më të mirë për vitin 2021, të cilëve iu dhanë dhurata përkatëse.

TAKIMET, SHËRBIMI PUBLIK DHE ADMINISTRATA

● Në emër të Komunës së Kumanovës, nënës së lumtur të foshnjës së parë të lindur në vitin e ri 2022, iu nda një librezë kursimi me mjete në vlerë prej një page mesatare dhe dhurata të përshtatshme.

● Në kuadër të Planit për Lëvizshmëri të Qëndrueshme Urbane (PLQU), të miratuar nga Këshilli në vitin 2020, Komuna e Kumanovës shpalli thirrje për përzgjedhjen e një kompanie, e cila duhet të përgatisë projekt propozim për zonën e këmbësorëve në qytet.

● NP "Ujësjellësi" - Kumanovë, në bashkëpunim me Komunën, ka realizuar disa projekte strategjike për përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së furnizimit me ujë të qytetarëve në Kumanovë. Projekti i stacionit të pompimit përmirëson cilësinë e punës së të gjithë impiantit të prodhimit të ujit, i rëndësishëm për funksionimin pa probleme të impiantit të ri të ujëmatësit të teknologjisë moderne, i cili ndodhet në ambientet ekzistuese të rikonstruktuara të impiantit të vjetër të trajtimit të ujit. Kjo zgjidhje siguron furnizim të vazhdueshëm me ujë me presionin e kërkuar në të gjithë impiantin e trajtimit të ujit, si dhe në impiantin e ri të ujëmatësit, i cili pritet të reduktojë humbjet e ujit nga 3% deri në 5%.



● Me blerjen e një impianti klori, në ambiente tërësisht të rinovuara, u instaluan pajisjet më moderne për automatizimin e procesit të klorinimit, duke siguruar kështu një proces më të sofistikuar, të monitoruar dhe më të sigurt të trajtimit të ujit të papërpunuar. Pajisjet e vjetra janë ndërruar pas 40 vitesh funksionim.



● Ka përfunduar rikonstruksioni i plotë i 17 dhomave në Shtëpinë e Pleqve “Zafir Saito”. Është prezantuar një sistem i ri elektronik modern për komunikimin e brendshëm ndërmjet përdoruesve shtëpiak dhe personelit mjekësor, si dhe personelit të kujdesit në shtëpi.

TAKIMET, SHËRBIMI PUBLIK DHE ADMINISTRATA

● Komuna e Kumanovës është komuna e parë në vend që ka ngritur sistemin e saj për matjen e ndotjes së ajrit në qytet, me 6 stacione të vendosura në lokacione të ndryshme të qytetit. Çdo qytetar, në baza ditore, mund të monitorojë ndotjen dhe gjendjen e ajrit përmes një linku të vendosur në faqen e internetit të Komunës.

● Në 100 ditët e fundit janë vendosur 833 kontejnerë të rinj, nga të cilët 400 kontejnerë të rinj në zonën urbane dhe periferi, dhe 433 kontejnerë të rinj janë vendosur në fshatrat Çerkez, Llopat, Lubodrag, Novosellë, Umin Doll, Sopot, Vojnoviq, Kosturnik, Arxhanoc, Pçinjë, Biljanovcë, Studena Bara.

● Me rastin e 8 dhjetorit, Shën Kliment Ohridski, kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Komunës së Kumanovës mbollën fidanë të rinj para kompleksit të pishinës së hapur dhe të brendshme të qytetit - Kumanovë.

● NP "Pastrimi dhe Gjelbërimi" mbolli 35 fidanë gjetherënës, 96 fidanë gjethmbajtës dhe 213 shkurre në lokacione të ndryshme të qytetit.

● Deponitë ilegale janë pastruar në më shumë se 20 lokacione: në rrugën "Vasil Dragomanski", drejt kazermës në rr. "Hekurudha", në rr. "Nikshiqka" dhe rr. "Titova Mitrovaçka", afër Stacionit të Autobusëve, në lokacionin Orhidea, në rr. "Goce Dellçev", në rr. "Varazhdinska", në vendbanimin Karposh, në rr. "B.B Gucman", në hyrje të qytetit ngjitur me pikën e karburantit të Makpetrolit, në Pçinjski Pat, në rr. "Gjorçe Petrov" në l. Pero Çiço, në rr. "620", në f. Priovcë, në rr. "Potok Serava" (Pastrimi i kanalit), rrugës për në kishën "Shën Kryeengjëlli Mikael", në rr. "Nikolla Teslla", në l. Pero Çiço, në ish-Hotel Kristal dhe vende të tjera në zonën e qendrës së qytetit.

KULTURË DHE SPORT

● Për nder të 78 vjetorit të vdekjes së komandantit legjendar të Kumanovës dhe heroit kombëtar Hristijan Todorovski Karposh, është vizituar Shtëpia-Muze e Karposhit në Kumanovë.

● Në Shtëpinë e Artizanateve Kumanovë, si ngjarje e njohur ndërkombëtarisht, me rastin e shënimit të Ditës së Shën Savës, festë kombëtare e serbëve në RSM, u mbajt Akademia solemne e Shën Savës.

● Me rastin e festës së Epifanisë – Uji i bekuar, kryetari Dimitrievski dhe kryetarja e Këshillit të Komunës së Kumanovës, Ivana Gjorgjievska, vizituan katedralen "Shën Nikolla" ku u mbajt një liturgji e shenjtë festive, pas së cilës u shenjtërua dhe u hodh Kryqi i Shenjtë.

● Në Shtëpinë e Zejtarëve u mbajt Akademi Solemne e organizuar nga Shoqata e Veteranëve të Armatës dhe Policisë me përbërje aktive dhe rezervë - Kumanovë për nder të komandantit dhe heroit kombëtar të Kumanovës Hristijan Todorovski Karposh.

● Delegacionet e kryesuara nga kryetari i komunës dhe kryetari i Këshillit të Komunës bënë homazhe për Goce Dellçevin, duke vendosur lule të freskëta në bustin e revolucionarit të madh.

● Me rastin e festës së Krishtlindjes u mbajt festimi i 23-të me tubim dhe kortezh të Krishtlindjeve, organizuar nga Shoqata e qytetarëve "Koledari" – Kumanovë.

KULTURË DHE SPORT

● Shoqata "Kortesionet e Krishtlindjeve" në Kumanovë ka festuar natën e Krishtlindjes. Një shpellë Krishtlindjesh me një afreske të Nënës së Zotit dhe Jezusit u ngrit në sheshin e qytetit.

● Dimitrievski së bashku me Shkëlqesinë e Tij Mitropolitin e Kumanovës dhe Osogovës, Ipeshkvin Gregori, vizituan kishën "Shën Kryeengjëlli Mikael dhe Gabriel", ku janë duke u zhvilluar aktivitete ndërtimore.

● Në Shtëpinë e Artizanateve u promovua filmi dokumentar për legjendën e hendbollit të Kumanovës, Çedomir Jordanovski - Çerçill, i autorit Marjan Stosevski.

● Vepra "Pikturë në xham e Shtëpisë së Artizanateve në Kumanovë", e autores Natasha Kuzmanovska nga Shkupi, është përzgjedhur si Suvenir i Komunës së Kumanovës për vitin 2021.

● Me iniciativë të kryetares së Këshillit të Komunës së Kumanovës, Ivana Gjorgjievska dhe Komisionit për arsim, sport dhe kulturë të Këshillit të Komunës, së bashku me të rinjtë, mësimdhënësit e artit dhe nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme komunale, u organizua aksion për të dekoruar sheshin e qytetit me dekorime Krishtlindjesh të punuara me dorë nga materiali i ricikluar-plastikë dhe stiropor.

KULTURË DHE SPORT

● U mbajt shfaqja premierë e filmit amator "Rrëfimi" - projekt i Nikollaj Pavlovskit dhe Marko Jovanovskit, i mbështetur nga Komuna e Kumanovës, i realizuar me një ekip prej 20 aktorësh të etnive të ndryshme dhe 20 persona shtesë në produksion.

● Me rastin e ditës së qytetit nga ana e Lidhjes Komunale të Sporteve u organizua një turne në futsall, në të cilin morën pjesë ekipe nga ndërmarrjet dhe institucionet publike të qytetit, duke përfshirë edhe një ekip nga Komuna e Kumanovës.

● Është mbajtur ekspozita e specializuar e Qenve të Sharrit, në të cilën përveç pjesëmarrësve vendas kanë marrë pjesë edhe pjesëmarrës nga Serbia dhe Çekia, në kategorinë e meshkujve dhe femrave.

● Kryetari Dimitrievski hapi garat "Born 2 run" në 3 km e 10 km, të organizuara nga Qendra për dialog ndërkulturor – Kumanovë, të realizuara me mbështetje teknike nga Misioni i OSBE-së – Shkup dhe SPB Kumanovë, me mbështetjen e Komunës së Kumanovës.

● Me rastin e Ditës së Qytetit, 11 Nëntor, u mbajt një akademi formale. Në akademinë formale u prezantua një video-prezantim për të arriturat e Komunës në vitin e fundit. Kryetari Dimitrievski ndau falënderime dhe pllakata për personat e njohur fizik dhe juridik që kanë kontribuar në zhvillimin e qytetit në sfera të ndryshme shoqërore.

KULTURË DHE SPORT

● Në prag të 11 Nëntorit, festës së Kumanovës sonë, në sheshin e qytetit u mbajt një mega koncert festiv ku morën pjesë: Spider, Tasko, Bardhi, Gjorgje David dhe Ivana Peters me Death Saw. Qytetarë të shumtë, pjesëtarë të bashkësive të ndryshme etnike të të gjitha gjeneratave, u argëtuan dhe festuan së bashku në frymën e harmonisë, unitetit dhe respektit të ndërsjellë.

● Me rastin e 11 Nëntorit patëm një pritje zyrtare të përfaqësuesve të qyteteve të binjakëzuara Bijelina dhe Novi Sad.

● Është mbajtur ekspozita tradicionale e artit-figurativ të artistëve kumanovarë, e organizuar nga IK Muzeu - Kumanovë.

● Në qendër të qytetit u mbajt gara tradicionale e atletikës rrugore, e organizuar nga Lidhja Komunale e Sporteve, Klubi i Atletikës Kumanova dhe Lidhja e Sporteve Shkollor.

● U mbajt takim tradicional festiv me ish-kryetarët e komunës, përfaqësues të ARM-së, MPB-së, SHVAP, NJTKZ-së dhe Lidhjes së veteranëve të LDB - SË, për të shënuar 77 vjetorin e çlirimit të Kumanovës dhe 502 vjetorin ekzistencës së suksesshme.

KULTURË DHE SPORT

● Në Shtëpinë e Artizanateve u mbajt promovimi i librit "2222 nofkat e kumanovarëve në dialekt kumanovar" nga bashkëqytetari ynë Mirko Zafirovski, si libri i tretë, kushtuar Kumanovës.

● Në restorantin "Gracia" u mbajt promovimi i monografisë "Gracia - krenaria e Kumanovës, mbretëresha e kateringut" të Dr. Primarius Jordan Paçkov, me rastin e 20 viteve të ekzistencës së suksesshme të këtij restoranti.

● Këtë vit bëhen 78 vjet nga lufta në f. Pelincë dhe vdekja e Angell Llazarevskit - Shajçe dhe Trifun Angelovskiz - Leteqi, luftëtarë të çetës së Kumanovës.

● Për nder të 11 Nëntorit, në Shtëpinë e Artizanateve, në organizim të Fondacionit për Kulturë dhe Sport, me seksionin historik në IK Muzeun - Kumanovë, është organizuar ekspozitë me fotografi nga Lufta Nacionalçlirimtare.

● Në Shtëpinë e Artizanateve u promovua libri "Jetë aktive me performancë të lartë psikofizike dhe mendore" nga profesori pensionist i edukatës fizike dhe shëndetësore, trajneri i futbollit dhe maratonisti Nikolla Koteski.

● Me rastin e 8 dhjetorit, Ditës së Shën Kliment Ohridskit në SHFK "Braqa Ribar" – f. Tabanoc u zbulua pllaka përkujtimore nga themelimi i shkollës, e cila daton nga viti 1927 dhe dëshmon për shkollën e parë të ndërtuar.

KULTURË DHE SPORT

● Në kuadër të programit festiv për shënimin e ditës së qytetit, u mbajt turneu - rapid, i organizuar nga Lidhja Komunale e Sporteve dhe Klubi i Shahut - Kumanova, me mbështetjen e Komunës së Kumanovës.

● Në IK Qendra e Kulturës "Trajko Prokopiev", për të 19-tën herë u hap ekspozita ndërkombëtare artistike "Karpino 2021", e organizuar nga qendra multimediale "Karpino", nën kujdesin e kryetarit të komunës dhe Këshillit të Komunës së Kumanovës, për nder të shënimit të 11 Nëntorit.

● Turneu i parë në badminton u mbajt në terrenin sportiv në SHFK "Vuk Karaxhiq" – Kumanovë, në organizim të Lidhjes Komunale të Sporteve dhe Lidhjes së Sporteve Shkollore.

● Në sallën e SHMK "Pero Nakov" u mbajt turneu tradicional në futsal për Kupën e Kryetarit, organizuar nga Lidhja Komunale e Sportit dhe Lidhja e Sporteve Shkollore, në kuadër të Programit për shënimin e Ditës së qytetit.

● Në këndin e lojërave sportive të SHMKT "Nace Bugjoni", në kuadër të programit "Ditët e Nëntorit 2021" u zhvillua turneu i basketbollit të shkollave të mesme 3 × 3, në konkurrencë për meshkuj dhe femra.

● Është mbajtur manifestimi jubilar i 20-të "Pivtijada 2022", për nder të festës fetare Epifania – Uji i bekuar, organizuar nga Qendra Multimediale "Karpino" – Kumanovë, nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës dhe Këshillit të Komunës së Kumanovës.

100 DITË BASHKË TË PËRKUSHTUAR PËR KUMANOVËN

15.900м²+
ASFALTIM DHE RIPARIM

4.800м+
KANALIZIM FEKAL

5.700м²+
KUBËZA BETONI

20+
PROJEKTE DHE AKTIVITETET NË SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME

1.300м²+
TROTUARE

4
FUSHA SPORTIVE TE KOMPLETUARA DHE 1 NË NDËRTIM

130+
FIDANË TË MBJELLUR RISHTAZI

20+
PASTRIMI DEPONIVE TË EGRA

KRYETARI DHE KËSHILLI I KOMUNËS SË KUMANOVËS

KOMUNA E KUMANOVËS
2022

Tigo